

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DREJTIMI GJUHËSI

Futuri në gjuhën shqipe

(Punim doktrate)

Prishtinë, 2020

UNIVERSITY OF PRISHTINA “HASAN PRISHTINA”

FACULTY OF PHILOLOGY

DEPARTMENT OF LINGUISTICS

The Future Tenses on the Albanian Language

(Doctoral thesis)

Prishtinë, 2020

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DREJTIMI GJUHËSI

Ardita Berisha MA

Futuri në gjuhën shqipe

(Punim doktrate)

Prishtinë, 2020

**UNIVERSITY OF PRISHTINA “HASAN PRISHTINA”
FACULTY OF PHILOLOGY
DEPARTMENT OF LINGUISTICS**

Ardita Berisha MA

**The Future Tenses on the Albanian Language
(Doctoral thesis)**

Prishtina, 2020

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

Ardita Berisha MA

Futuri në gjuhën shqipe

(Punim doktrate)

Mentori: Prof. dr. Bardh Rugova

Prishtinë, 2020

Përmbledhje

Definicionet për kohën zakonisht e përkufizojnë atë si kategori gramatikore që ka të bëjë me lokalizimin e situatës në kohë dhe që gjen shprehje sistematike në kundërvëniet gramatikore (Comrie, 2000:9, Lyons, 2001:284; Givon, 2001:285,286; Declerck, Read dhe Capelle, 2006:94;). Si kategori gramatikore, ajo vendos marrëdhënie midis kohës së situatës dhe kohës së shprehjes, ku koha e shprehjes i përket çastit të ligjërimit (Lyons, 1995:313-314). Në këtë mënyrë, siç thekson Lyons-i, koha përfshin jo vetëm referencën kohore, por edhe atë deiktike, d.m.th. ajo paraqet referencë në një pikë apo interval kohor i cili përcaktohet në relacion me çastin e ligjërimit. P.sh. koha e tashme, në kuptimin primar të saj, i referohet ose momentit të shprehjes në vetvete (pika kohore zero – tani – këtu, dhe tani – konteksti deiktik) ose, më shpesh, një intervali ose periudhe kohore e cila e përmban edhe momentin e shprehjes.

Bazuar në konceptet e gramatikave tradicionale (ASHSH, 2002), e ardhmja apo futuri është një nga antarët e sistemit tresh sipas së cilit është ndarë kategoria gramatikore e kohës në gjuhët klasike dhe në gjuhët e tjera indoevropiane, gramatikat e së cilave janë mbështetur në ato dy gjuhë. Kështu, çdo veprim/gjendje/ngjarje që ndodh para çastit të ligjërimit i përket **së shkuarës**, veprimi/gjendja apo ngjarja që ndodh në një moment që e përfshin edhe çastin e ligjërimit, i përket **së tashmes**, ndërsa veprimi/gjendja/ngjarja që pritet apo parashihet të ndodhë në të ardhmen i përket **së ardhmes** apo futurit.

Mirëpo, situata që pritet të ndodhë pas çastit të ligjërimit është e parashikuar, e pritshme, jofaktuale, prandaj ajo dallon nga situata që i përket çastit të ligjërimit, apo ndonjë çasti që ndodhet para tij. Në këtë pikë e ardhmja dallon nga e shkuara dhe e tashmja. Gjersa e ardhmja shpreh një situatë joreale, jofaktuale, e tashmja dhe e shkuara shprehin situata reale, faktuale. Rrjedhimisht, kur folësi flet për një situatë të së ardhmes, nuk mund të jetë neutral, por do ta shprehë qëndrimin e tij ndaj asaj suate. E qëndrimi i folësit ka të bëjë me modalitetin.

Klasifikimi tradicional i kategorisë së kohës në sistem të ndarë në tresh është bërë në kuadër të mënyrës dëftore. Nga pikëpamja e modalitetit, dëftorja është konsideruar mënyrë e foljes neutrale, jomodale. Prandaj, vetëm në kuadër të kësaj mënyre është bërë ndarja e kategorisë së kohës në sistem tresh. Demiraj (1988:709) thekson se ndryshe nga dëftorja, që përmban tri diferencime kohore, të cilat përmbajnë nënklasifikime të mëtejme, mënyrat e tjera të foljes

përmbajnë më pak diferencime të tilla, për shkak se llojet e modaliteteve që shprehin ato nuk ua mundësojnë atë. P.sh. dëshirorja *punofsha*, si mënyrë nëpërmjet së cilës shprehet dëshira e folësit në formë urimi a mallkimi, ka në përdorim një formë kohore që në gramatikë i referohemi si kohë e tashme, por që kuptimisht më shumë i referohet së ardhmes. Kjo është e kuptueshme, meqë lloji i modalitetit, dëshirueshmëria, lidhet me veprime a situata që priten të shfaqen pas çastit të ligjërit. E njëjta gjë ndodh edhe me urdhërorën *shko, shkoni*: dëshira e folësit e shprehur në formë të urdhrit, të kërkesës apo të lutjes, ka të bëjë me situata që priten të shfaqen pas çastit të ligjërit.

Rrjedhimisht, vështruar nga referenca kohore që shprehin, trajtat së ardhmes bashkë me trajtat e mënyrave jodëftore dhe johabitore në gjuhën shqipe, ndonëse u përkasin mënyrave të ndryshme, ato shprehin të njëjtën referencë kohore të së ardhmes (ndërsa ndryshojnë në përmbajtjen e tyre modale). Vështruar nga struktura kohore, koha e situatës së shprehur (apo koha e referencës) dhe koha e shprehjes si qendër deiktike (që është çasti i ligjërit), edhe trajta kohore e së ardhmes, edhe ajo e dëshirores dhe e urdhërores, paraqesin të njëjtën strukturë kohore: ***Do të shkojnë së shpejti/ Shkofshin sa më shpejt!/ Shkoni sa më shpejt!*** Në raport me kohën e shprehjes (apo çastin e ligjërit), që shërben si qendër deiktike (që është e tashmja), koha e situatës *do të shkojnë/shkofshin/shkoni*, në secilin rast paraqet një situatë të së ardhmes, në formë të parashikimit, të dëshirës dhe të urdhrit.

Në gramatikat tradicionale përshkrimi dhe klasifikimi i kategorisë së mënyrës është bërë duke marrë bazë llojet e modaliteteve që shprehen nëpërmjet trajtave foljore përkatëse. Trajta *do* + lidhore, që është një nga trajtat e së ardhmes në gjuhën shqipe, në përdorimin më të zakonshëm të saj, e ka përgjithësuar përmbajtjen modale të vullnetit apo të dëshirës që ka pasur fillimisht, dhe e ka theksuar referencën kohore të së ardhmes. Prandaj, në gramatikat tradicionale (ASHSH, 2002; Demiraj, 1988) ajo konsiderohet trajtë kohore dhe trajtohet në kuadër të dëftores. Megjithëse e ka përgjithësuar këtë përmbajtje modale, ajo prapëseprapë shpreh një parashikim të folësit për të ardhmen. Parashikimi nuk mund të konsiderohet si koncept thjesht kohor, patjetër ai është edhe koncept modal. Madje, për shkak të burimit leksikor prej të cilit ka dalë, dhe interferencës me kontekste të caktuara, trajta *do* + lidhore mund të shprehë përmbajtje modale të theksuara (një përfundim të arsyeshëm epistemik, vullnet, urdhër, premtim etj.).

Për shkak të natyrës jofaktuale që ka, e ardhmja apo futuri nuk mund të konsiderohet kohë në kuadër të dëftores. Statusi jofaktual i karakterizon edhe mënyrat e tjera jodëftore, dhe johabitore, lidhoren, dëshiroren e urdhëroren. Trajtat foljore përkatës *do të shkoj, kam me shku, shko, shkofsha, të shkoj*, të gjitha paraqesin të ardhme, shoqëruar nga modalitetet e ndryshme (parashikim i thjeshtë, obligim, dëshirë, urdhër).

Në studimet e kohëve të fundit (Bybee, 1994; Palmer, 2001) faktualiteti i shprehur është kriteri bazë që merret për përshkrimin e kategorisë së mënyrës, si dhe të modalitetit në tërësi. Në gjuhën shqipe një kriter të tillë përshkrimi dhe klasifikimi, qysh në vitin 1966 (botuar më 1997) ka propozuar Selman Riza, ndërsa në studimet e kohëve të fundit këtë kriter ka propozuar B. Ismajli (2009:86).

Prandaj, përshkrimi i kategorisë së mënyrës, që operon me konceptin e faktualitetit, do të paraqesë një përshkrim më të përgjithësuar të kësaj kategorie të foljes. Në këtë mënyrë do të dallohet ajo që është faktuale (apo me terma të Rizës 1997, efektivisht ekzistuese), nga ajo që është jofaktuale - e pritshme, potenciale, e domosdoshme, e dëshirueshme, hipotetike (apo me terma të Rizës, potencialisht ekzistuese). Përshkrimi i kategorisë së mënyrës bazuar në kriterin e faktualitetit do ta paraqesë nevojën e riorganizimit edhe të kategorisë së mënyrës, edhe të kategorisë së kohës në gjuhën shqipe. Kështu, do të shihet se brenda dëftores, ekziston një dallim ndërmjet kohës së shkuar e së tashmes në njërën anë, kundrejt së ardhmes, në anën tjetër.

Klasifikimi i mënyrave dhe i modalitetit mbështetur në kriterin e faktualitetit, në njërën anë do ta veçojë dëftoren dhe (kryesisht) habitoren, si mënyra që shprehin situata faktuale, si mënyra **realis**, dhe në anën tjetër, të ardhmen apo futurin dhe mënyrat e tjera si dëshiroren, urdhëroren dhe lidhoren, që shprehin jofaktualitet në forma të ndryshme, pritshmëri apo parashikim, shprehur në nuanca të ndryshme modale, dëshirë/vullnet, nevojë (domosdoshmëri), mundësi, urdhër, nxitje, lejim, si realizime të ndryshme të situatave **irealis** në gjuhën shqipe.

Diferencimi realis – irealis është aplikuar për përshkrimin dhe klasifikimin e mënyrave dhe modaliteteve të tjera në studimet që janë bërë dekadave të fundit për këto kategori gramatikore (Bybee, 1988; Bybee et al. 1994; Chung dhe Timberlake, 1985; Givon, 1994; Palmer, 2001; etj.). Dallimi realis – irealis në thelb ka të bëjë me dallimin ndërmjet një situatë të aktualizuar apo të realizuar, faktuale, nga një situatë që është ende e paaktualizuar, e parealizuar dhe jofaktuale.

Prandaj, termi *irealis* përdoret për t'iu referur atyre llojeve të situatave që shprehin urdhra, kushte hipotetike (kondicionalët), pyetje, situata të ardhshme ose të mundshme, qëllime dhe modalitete të ngjashme. Rrjedhimisht, fusha konceptuale që shprehet nëpërmjet kategorisë *irealis*, kryesisht përputhet me fushën funksionale të modalitetit (Bybee, 1998:264; Palmer, 2001:3).

Në gramatikat e gjuhës shqipe trajtohen tre tipa trajtash gramatikore që shërbejnë për ta shprehur të ardhmen. Trajta e ndërtuar mbi bazën e lidhore, e prirë nga pjesëza modale *do* + folja në lidhore: *do të punoj*, që është tipi kryesor i futurit, tipi tjetër që ka përdorim shumë më të ngushtë, i ndërtuar mbi bazën e trajtës së pashtjellueshme të tipit *për të larë*, prirë nga format vetore të foljes *kam*: *kam për të larë* (ASHSH, 2002:290-291, Demiraj, 1988:823; Topalli, 2011:860-861)) dhe trajta geqe e futurit, e ndërtuar nga folja ndihmëse *kam* + paskajorja geqe: *kam me punu(e)* (Demiraj, 1988:823; Topalli, 2011:860-861).

Është mjaft karakteristik fakti se përveç këtyre, në gjuhën shqipe ekzistojnë edhe mjete të tjera të gramatikalizuara që shprehin referenca kohore të së ardhmes. Këto trajta foljore janë ndërtuar nga modalet *mund/le* (dhe deri diku *duhet*) + folja kryesore në lidhore. Në këto trajta foljore, elementi i parë i strukturës është ngurosur dhe kaluar në pjesëz modale pasi që të gjithë shenjuesit gramatikorë i merr folja në lidhore (me përjashtim të *duhet*, e cila ende nuk është ngurosur plotësisht). Krahas trajtës *do* + lidhore, e njohur si trajtë e futurit, edhe këto trajta përdoren për të shprehur lloje të ndryshme modalitetesh. Këto trajta foljore janë ndërtuar mbi bazën e lidhore. Në gjuhën shqipe lidhoreja është mënyrë e foljes e cila, në një kuptim shumë të përgjithësuar, duke shprehur një situatë të së ardhmes, shpreh modalitet të mundësisë. Nga ana formale ajo ka formë analitike: *të punoj*. Megjithëse ajo ka formë morfologjike analitike të kristalizuara, gjithnjë ka nevojë për plotësime dhe përforcime modale në përputhje me kuptimet e gjera sintagmatike të saj, të cilat e veçojnë atë nga tërë sistemi mënyror i shqipes (Likaj, 2014:38). Kështu, ajo është mënyra e foljes me më së shumti kombinime, ndërsa me shumë pak funksione që janë specifike vetëm për të (Breu, 2009:459).

Gjersa, siç pohon Palmeri (2001:4), në disa gjuhë të Evropës lidhoreja tashmë është duke dalë nga përdorimi, përkundrazi në gjuhën shqipe, pas dëftores, ajo është mënyra me përdorimin më të gjerë. Në gjuhën shqipe, përveç përdorimit si lidhore, mbi bazën e saj janë ndërtuar trajtat *do/mund/le* + lidhore që sot janë të gramatikalizuara. Këto trajta gramatikore shprehin po ato

modalitete të cilat në gjuhë të tjera, si p.sh. në gjuhën angleze, shprehen me anë të sistemit modal (shih Palmer, 2001; Huddleston, 2002). Kështu, përderisa në gjuhën angleze lidhorja praktikisht është zhdukur dhe është zëvendësuar nga sistemi modal (Palmer, 2001:4), në gjuhën shqipe, krahas përdorimit të zakonshëm të lidhore, funksionit lidhës në klauza të varura apo edhe përdorimit të saj në klauza të thjeshta, janë krijuar edhe trajtat gramatikore siç janë *do* + lidhore, *mund* + lidhore dhe *le* + lidhore. Tashmë këto janë trajta të gramatikalizuara, brenda të cilave janë krijuar nga katër diferencime kohore. Një prirje të tillë gramatikalizimi paraqet edhe *duhet* + lidhore, por ajo ende nuk është gramatikalizuar plotësisht.

Megjithëse janë trajta të gramatikalizuara, modalitetet që shprehin trajtat *mund/le/do* + lidhore (dhe struktura *duhet* + lidhore) dallojnë nga llojet e modaliteteve që shprehen nëpërmjet mënyrave të foljes. Të parat shprehin modalitete të shkallëzuara nga mundësia, një modalitet i dobët e deri te domosdoshmëria, që nënkupton një modalitet të fuqishëm, ndërsa të dytat shprehin lloje të tjera modalitetesh si, dëshirë, urdhër, habi.

Trajta *do/le/mund* + lidhore (+ struktura e lirë *duhet* + lidhore) bashkohen në tiparet e përbashkëta që kanë: referencën e së ardhmes, të qenët modale dhe gjithashtu nga ana formale, të gjitha janë krijuar mbi bazën e lidhore. I vetmi tipar dallues i tyre mbetet lloji i modalitetit që shprehin ato. Prandaj, ato i përkasin të njëjtit grup. Varësisht nga qëndrimi që ka folësi ndaj situatës së parashikuar, e përdor trajtën përkatëse. Ndërsa, me mënyrat e tjera jodëftore, dhe johabitore, trajta *do/le/mund* + lidhore bashkohen në komponentin konceptual të tyre, mungesën e faktualitetit që shprehin. Në këtë mënyrë, mund të shihet se situatat e së ardhmes apo situatat jofaktuale, nëpërmjet mjeteve të gramatikalizuara në gjuhën shqipe, mund të shprehen në dy mënyra: **1)** nëpërmjet mënyrave jodëftore (dhe johabitore), pra, lidhore, dëshirores dhe urdhërores (modalitete të tilla si mundësi, qëllim, dëshirë, urdhër), dhe **2)** nëpërmjet trajtave që janë krijuar brenda lidhore, nëpërmjet trajtave *do/mund/le* + lidhore e trajtave *kam* + paskajore ose *kam* + trajta e pashtjellueshme *për të punuar* (si lloje të ndryshme dhe shkallë të ndryshme modale: vullnet, domosdoshmëri, mundësi etj.). Kështu, situatat jofaktuale hyjnë në kuadër të mënyrës **irealis**, ndërsa ato faktualet paraqesin mënyrën **realis**.

Ky studim, në pjesën e parë të tij, paraqet një trajtim teorik dhe analitik, fillimisht për kategorinë e kohës, e pastaj edhe për kategorinë e modalitetit dhe të mënyrës në gjuhën shqipe. Pastaj, në mënyrë që studimi të jetë i mbështetur me të dhëna të sakta nga gjuha në përdorim, ai

është mbështetur në një korpus të gjerë, që përmban të dhëna jo vetëm nga varieteti standard, por edhe nga varietetet e tjera të shqipes. Në këtë mënyrë, korpusi përmban të dhëna të nxjerra nga:

1. *Korpusi Nacional i Gjuhës Shqipe* (në të cilin gjendet një numër i konsiderueshëm tekstesh të ndryshme letrare e joletrare, që i përkasin varietetit standard dhe varieteteve të tjera);
2. të dhëna të nxjerra nga dy vëllimet e romanit autobiografik të Bekim Fehmiut, “*E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme*” (2011) dhe “*Skëlqim dhe tmerr*” (2015);
3. drama “*Loja e mbasdrekës*” të (2012) dhe romani “*Djella*” (2012) të autorit Martin Camaj;
4. një numër i gazetës ditore “*Koha Ditore*” (18 dhjetor, 2012);
5. dhe skenari i filmit “*Zoti i unazave*”.

Të dhënat e nxjerra nga korpusi i janë nënshtruar më shumë analizës cilësore, e më pak asaj sasiore. Analizë sasiore është bërë vetëm në disa raste për të parë një trajtë specifike, sa ka përdorim në një kuptim modal të caktuar, e sa në një tjetër. Ndërsa analiza cilësore është mbështetur në metodat deskriptive, analitike, teorike dhe krahasuese.

Fjalët kyçe: futur, referencë kohore, kohë, faktualitet, jofaktualitet, jodëftore, reale, joreale, modalitet, mënyrë, trajtë e gramatikalizuar

Summary

Tense is usually defined as a grammatical category related to the localization of the situation in time, which finds systematic expression in grammatical contrasts (Comrie, 2000: 9; Lyons, 2001: 284; Givon, 2001: 285, 286; Declerck, Read and Capelle, 2006: 94). As a grammatical category, it establishes the relation between the time of situation and the time of the utterance, where the time of the utterance belongs to the moment of speech (Lyons, 1995: 313-314). In this way, as Lyons points out, time includes not only temporal but also deictic reference, that is, it represents reference to a point or time interval, which is determined in relation to the moment of speech. For example, the present tense, in its primary sense, refers either to the moment of utterance itself (temporal ground zero - now - here, and now - deictic context) or, more often, to a time period which contains the moment of utterance.

Based on the concepts of traditional grammar (ASHSH, 2002), the future is one of the members of the ternary system according to which the grammatical category of tense is categorized in classical and other Indo-European languages whose grammars are based on these two languages. Thus, any action/state/event that occurs before the moment of speech belongs to the **past**, the action/state/event that occurs at a moment which contains the moment of speech belongs to the **present**, whereas the action/state/event expected or anticipated to occur in the future belongs to the **future**.

However, the situation after the moment of speech is anticipated, expected, non-factual, and thus differs from the situation that belongs to the moment of speech, or any moment before it. At this point the future is different from the past and the present. While the future expresses an unreal, non-factual situation, the present and the past express real, factual situations. Consequently, when the speaker speaks of a future situation, he/she may not stay neutral but will express his attitude towards that situation. Modality is concerned with the speaker's attitude.

The traditional classification of the category of tense into a ternary system was done in the framework of the indicative mood. In terms of modality, the indicative mood was considered to

be a neutral, non-modal verb mood. Therefore, it is only in the framework of this mood that the tense category is divided into a ternary system. Demiraj (1988: 709) points out that unlike the indicative, which contains three temporal differentiations, which again contain further subclassifications, other verb moods contain less such differentiations because the types of modalities they express do not permit such a thing. For example, the optative *punofsha* “may I work”, as a mood expressing speaker’s wish in the form of wishes or curses, uses a tense form which in grammar is referred to as the present, but which semantically refers more to the future. This is expected, since the type of modality, namely desirability, concerns actions or situations that are expected to occur after the moment of speech. The same applies to the imperative: *shko, shkoni* “go”: speaker’s wish expressed in the form of a command, request, or plea, concerns situations that are expected to occur after the moment of speech. Consequently, in terms of the temporal references they express, the forms of the future along with the forms of the non-indicative and non-admirative moods in the Albanian language, although belonging to different moods, express the same temporal reference of the future (while varying in their modal content). In terms of the temporal structure, the time of the situation expressed (or the reference time), the time of the utterance as the deictic center (which is the moment of speech), the temporal form of the future, and that of the optative and the imperative, represent the same temporal structure. *Do të shkojnë së shpejti/ Shkofshin sa më shpejt!/ Shkoni sa më shpejt!* “They will go soon/May they go soon!/Go soon!” In relation to the time of utterance (or the moment of speech), which serves as the deictic center (which is the present), the time of situation *do të shkojnë/shkofshin/shkoni* “will go/may they go/go”, in each case presents a future situation in the form of anticipation, wish, and order.

In traditional grammar the description and classification of the mood category is made by taking into account the types of modalities expressed through their respective verbal forms. The *do* + subjunctive form, which is one of the future forms in the Albanian language, in its most common use, has generalized the modal content of the volition or desire that it originally had, and emphasized the temporal reference of the future. Therefore, in traditional grammar (ASA, 2002; Demiraj, 1988) it is considered a tense form and is treated within the indicative. Although it has generalized this modal content, it nevertheless expresses speaker’s prediction towards the future. Prediction cannot be considered a purely temporal concept; it is definitely a modal concept as well. Furthermore, due to the lexical source from which it derives, and the

interference with certain contexts, the *do* + subjunctive form may express emphasized modal content (a reasonable epistemic conclusion, volition, order, promise, etc.).

Due to its non-factual nature, the future cannot be considered a tense within the indicative. The non-factual status also characterizes other non-indicative and non-admirative moods: the subjunctive, the optative, and the imperative. The corresponding verb forms *do të shkoj*, *kam me shku* “[I] will go”, *shkofsha* “may I go”, *shko* “go”, *të shkoj* “to go”, all represent the future, accompanied by different modalities (simple prediction, obligation, volition, order).

In recent studies (Bybee, 1994; Palmer, 2001) the expressed factuality is the basic criterion taken when describing the category of mood as well as the modality as a whole. In Albanian such a description and classification criterion has been proposed by Selman Riza back in 1966 (published in 1997), whereas in recent studies this criterion has been proposed by B. Ismajli (2009: 86).

Therefore, the description of the category of mood, which functions with the concept of factuality, will present a more generalized description of this verb category. It will distinguish what is factual (or in terms of Riza 1997, effectively existing) from what is non-factual - expected, potential, necessary, desirable, hypothetical (or in terms of Riza, potentially existing). The description of the mood category based on the factuality criterion will present the need to reorganize both the mood category and the tense category in Albanian. Thus, it will be seen that, within the indicative, there is a difference between the past and present tenses, on the one hand, and the future, on the other.

Categorization of mood and modality based on the criterion of factuality will on the one hand separate the indicative and (mainly) the admirative as moods expressing factual situations, as **realis** moods, and on the other, the future and other moods, such as the optative, the imperative, and the subjunctive, as moods expressing non-factuality in various forms: expectation or anticipation, expressed in various modal nuances, desire/volition, need (necessity), possibility, order, incitement, permission, as different realizations of **irrealis** situations in the Albanian language.

Realis-irrealis distinction has been applied to describe and classify other moods and modalities in studies done in recent decades regarding these grammatical categories (Bybee,

1988; Bybee et al. 1994; Chung and Timberlake, 1985; Givon, 1994; Palmer, 2001; etc.). The realis-irrealis distinction is primarily about distinguishing between an actual, realized, and factual situation, from a situation that is still unactualized, unrealized, and non-factual. Therefore, the term *irrealis* is used to refer to those types of situations that express orders, hypothetical conditions (conditionals), questions, future or potential situations, and similar intents and modalities. Consequently, the conceptual domain expressed through the irrealis category largely conforms to the functional domain of modality (Bybee, 1998: 264; Palmer, 2001: 3).

In Albanian grammar there are three types of grammatical forms that serve to express the future. The form constructed on the basis of the subjunctive, preceded by the modal particle *do* + verb in subjunctive: *do të punoj* “[I] will work”, which is the main type of the future; the other type having much narrower use, constructed on the basis of the non-finite form *për të larë* “to wash”, preceded by the personal forms of the verb *kam* “have”: *kam për të larë* “[I] have to wash (ASHSH, 2002: 290-291; Demiraj, 1988: 823; Topalli, 2011: 860-861)); and the Gheg future form, constructed from the auxiliary verb *kam* + gheg infinitive: *kam me punu(e)* “[I] have to work (Demiraj, 1988: 823; Topalli, 2011: 860-861).

It is quite characteristic that in addition to these, there are other grammaticalized tools in the Albanian language which express temporal references to the future. These verb forms are constructed from modals *mund/le* (and to some extent *duhet*) + the main verb in the subjunctive. In these verb forms, the first element of the structure is fixed and has become a modal particle as all the grammatical markers are taken by the verb in the subjunctive (except *duhet*, which has not yet been fully fixed). Along with *do* + subjunctive, known as the future form, these forms are also used to express different types of modalities. These verb forms are constructed on the basis of the subjunctive. In Albanian the subjunctive is a verb mood which, in a very general sense, by expressing a future situation, expresses modality of possibility. Structurally, it has an analytical form: *të punoj* “to work”. Although it has a crystallized analytic morphological form, there was always a need for modal complementation and reinforcement in accordance with its broad syntagmatic meanings, which set it apart from the entire Albanian modal system (Likaj, 2014: 38). Thus, it is the verb mood with the most combinations, yet with very few functions that are specific for it only (Breu, 2009: 459).

While, as Palmer (2001: 4) asserts, in some European languages the subjunctive is already getting out of use; on the contrary, in the Albanian language, it is the most widely used mood after the indicative. In the Albanian language, besides its use as subjunctive, the *do/mund/le* + subjunctive forms that are now grammaticalized are built on its basis. These grammatical forms express the same modalities, which in other languages, such as English, are expressed through the modal system (see Palmer, 2001; Huddleston, 2002). Thus, while in English the subjunctive has virtually disappeared and has been replaced by the modal system (Palmer, 2001: 4), in Albanian, besides its common use, the connective function in subordinate clauses or even its use in simple clauses, grammatical forms such as *do* + subjunctive, *mund* + subjunctive, and *le* + subjunctive have also been created. These are now grammaticalized forms within which four temporal differences exist. Such a grammaticalization tendency is also shown by *duhet* + subjunctive, but it has not yet been fully grammaticalized.

Although grammaticalized forms, the modalities expressed through *mund/le/do* + subjunctive (and the structure *duhet* + subjunctive) differ from the types of modalities expressed through verb moods. The former express moods ranging from possibility, a weak modality, to necessity, which marks strong modality, while the latter express other types of modalities, such as desire, command, and surprise.

The *do/le/mund* + subjunctive form (+ the free structure *duhet* + subjunctive) come together in the common features they share: future reference and modality, and also structurally they all are constructed on the basis of the subjunctive. Their only distinctive feature remains the type of modality they express. Therefore, they belong to the same group. Depending on the attitude of the speaker towards the predicted situation, the appropriate form is used. Whereas, with other non-indicative and non-admirative moods, the *do/le/mund* + subjunctive forms come together in their conceptual component, namely the lack of factuality they express. In this way, it can be seen that future situations or non-factual situations, through grammaticalized tools in the Albanian language, can be expressed in two ways: **1)** through non-indicative (and non-admirative) moods, that is, the subjunctive, the optative, and the imperative (modalities such as possibility, intent, desire, order), and **2)** through the forms that are constructed within the subjunctive, through *do/mund/le* + subjunctive and *kam* + infinitive or *kam* + non-finite form *për të punuar* “to work” (as different modal types and degrees: volition, necessity, possibility, etc.).

Thus, non-factual situations fall within the **irrealismood**, while the factual ones represent the **realismood**.

In its first part, this study presents a theoretical and analytical approach, first for the category of tense, then for the category of modality and mood in Albanian. Then, in order for the study to be supported with accurate data from the language in use, it relies on a large corpus containing not only the standard variety but also other varieties of Albanian. In this way, the corpus contained data extracted from: 1. *The National Corpus of the Albanian Language* (containing a considerable num

ber of different literary and non-literary texts, belonging to the standard variety and other varieties); 2. data extracted from two volumes of Bekim Fehmiu's autobiographical novel, "*E shkëlqyeshme dhe e tmerrshme*" (2011) and "*Skëlqim dhe tmerr*" (2015); 3. the play "*Loja e mbasdrekës*" (2012) and the novel "*Djella*" (2012) by Martin Camaj; 4. one volume of the daily newspaper "*Koha Ditore*" (December 18, 2012); 5. and the screenplay of the movie "*The Lord of the Rings*".

The data extracted from the corpus have been subjected to more qualitative and less quantitative analysis. Quantitative analysis has only been carried out in a few cases to see how much a specific form is used in a particular modal sense and how much in another. Qualitative analysis, on the other hand, is based on descriptive, analytical, theoretical, and comparative methods.

Keywords: future, temporal reference, tense, factuality, non-factuality, non-indicative, realis, irrealis, modality, mood, grammaticalized form